



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 26.10.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

Mbi projektligjin **“Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”**

Drejtuar: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi shqyrtoi në mbledhjen e datës 26.10.2018 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin *“Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”*.

I. Qëllimi dhe objektivi i projektligjit:

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it.

Kjo marrëveshje ka si qëllim përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor, si dhe lehtësimin e bashkërendimit të hetimeve e të ndjekjeve penale, që shtrihen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë progres në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe terrorizmit. Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Terrorizmit, 2014-2020, u përditësua në nëntor të vitit 2014 dhe përfshin luftën kundër trafikimit të fëmijëve, luftën kundër pastrimit të parave dhe luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike.

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve dhe progresit të bërë në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe terrorizmit, ende ka mjaft problematika në sistemin gjyqësor si mungesa e bashkëpunimit midis agjencive të zbatimit të ligjit, ekzistenca e vështirësive

në krijimin e të dhënave të gjurmueshme, të besueshme, të hetimeve parandaluese, të proceseve dhe dënimeve të shoqëruara me përdorimin sistematik të hetimeve financiare, mungesa e koordinimit ndaj luftës kundër prodhimit dhe trafikimit të drogave etj.

Në këto kushte, me qëllim intensifikimin e masave të ndërmarra nga ana e shtetit shqiptar, në kuadër të përmirësimit të klimës në drejtësi, lidhja e një marrëveshjeje me Eurojust-in, do të nxisë bashkërendimin real mes hetimeve ekzistuese në më shumë se një vend anëtar, nëpërmjet shkëmbimit të menjëhershëm të akteve, dokumenteve dhe informacioneve.

➤ Objektivat kryesorë të këtij akti janë:

- a) Fuqizimi i bashkëpunimit në luftën kundër krimeve të rënda, veçanërisht krimin të organizuar dhe terrorizmit;
- b) Bashkërendimi dhe financimi i veprimeve hetimore të përbashkëta, njëkohësisht me financim të BE-së, nëpërmjet skuadrave hetimore të përbashkëta;
- c) Garantimi i një niveli mbrojtjeje për të dhënat personale të ofruara nga pala tjetër, në respektim të Konventës së Këshillit të Evropës, të 28 janarit 1981, “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, dhe të parimeve të përcaktuara në vendimin e Eurojust-it.

II. KONKLUSIONE

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare duke vlerësuar rëndësinë e kësaj marrëveshjeje dhe përfitimeve të shumta që sjell për shtetin shqiptar, me shumicën e anëtarëve miraton projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi si dhe shprehet dakord për kalimin e këtij pr/ligji në seancë plenare.

Relator

Xhemal Qefalia

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ